



Më  
Dana

30. 10. 2017

PKR.nr. 196/16

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale me kryetarin e trupit gjyku - gjyqtarin Sahit Krasniqi, me sek juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna [REDACTED], për vepren penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedit të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.126/16 të datës 28 dhjetor 2016, pas mbajtjes së shqyrimit filletar me dt.09.02.2017, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës prokurorit të shtetit Florije Salihu-Shamolli të akuzuarit [REDACTED] të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED] I lindur me dt. [REDACTED] në fsh. [REDACTED] Komuna [REDACTED] nga I ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] me vendbanim të njejt, shqiptar, shtetas I R. Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme, me profesion bujk, I martuar, babe I 4 fëmijve I gjendjës së varfer ekonomike, mbrohet në liri..

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse :** me datën 04.10.2014 në fshatin Zborc, Komuna Shtime, gjatë një kontrolli nga ana e policies tek I pandehuri është gjetur një pushkë e gjuetisë dy tytëshe e tipit "Bokerice" kal. 12 mm, me numer serik 128865 prodhim turk dhe tre cope fishek të gjuetisë të kalibrit 12 mm, ku I pandehuri e ka mbajtur në pronësi, kontroll të pa autorizuar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, ku pushka është konfiskuar nga ana e policies.

- me çka kreu vepren penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të të KPRK-së..

Në bazë të dispozitiës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit I,

**CAKTON**  
**DËNIM ME KUSHTË**

**Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti**, i cili nuk do të ekzekutohet nëse I pandehuri në periudhën kohore prej 1/një/viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryenë vepër tjetër penale.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme pushka e gjuetisë dy tytëshe e tipit “Bokerice” kal. 12 mm, me numer serik 128865, prodhim turk dhe 3 copë fishek të kal. 12 mm.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30/tridhjet/€ në afat prej 15 /pesëmbëdhjet/ ditëve pasi aktgjykimi të mere formen e prerë.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.126/16 të datës 28 dhjetor 2016 ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED], për veprën penale: “ mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga nen 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.02.2017, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Florije Salihu - Shamolli, mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri [REDACTED] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e saj, dhe shton se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe premton se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, është mbajtës i familjes dhe është i gjendjes së varfër ekonomike, gjithashtu shtoi se armën e ka mbajtur me qëllim të ruajtjes së misrit nga derrat e egër.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.I të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
  - pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri
  - pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përban aktakuza, në materiale te prezantuara nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: vërtetimi për sekuestrimin e sendeve i dt. 05.10.2016 si dhe fotografat të cilat gjenden në shkresat e lëndës,
- aktakuza nuk përban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.I të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*)

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive te veprës penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga nen 374 par.I të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, si rrethana **veganërisht lehtësuese** mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ndërsa si rrethana

lehtësuse mori parasysh se I pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra te tilla apo të ngjashme, është I gjendjës së varfër ekonomike, ndersa në mungesë të rr Ethanave vepanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkret të veprës penale mbi bazen e rr Ethanave të tilla, gjyakta I shqiptoi **denim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti** i cili denim nuk do të ekezutohet në periudhen kohore prej **1/një/ viti** nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryenë vepër tjetër penale, me bindjen se në rastin konkret edhe përmes shpalljes së dënimit dhe pa egzekutimin e tij do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe qëllimi i përgjithëshëm i dënameve, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshen e vepres penale, rr Ethanave të kryerjes së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe përsoshat e të pandehurit.

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së, pushka e gjuetisë dy tytëshe e tipit "Bokerice" kal. 12 mm, me numer serik 128865, prodhim turk dhe 3 copë fishek të kal. 12 mm, i është konfiskuar në mënyrë të përhershme.

Konformë nen. 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/ euro, e cila është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikshmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërkcura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA,**

**PKR.nr.196/16 të dt. 09.02.2017**

Sekretaja Juridike

Adelina Sallahu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Kryetari i trupit gjykuar,

Sahit Krasniqi